



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet më të fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Këtë javë, dëshmitari i katërt i thirrur nga Zyra e Prokurorit të Specializuar në çështjen gjyqësore *Hashim Thaçi dhe të tjerët* vazhdoi dhënien e dëshmisë. Gjatë kësaj kohe Mbrojtja mori në pyetje dëshmitarin. Dëshmitari e dha dëshminë në seanca private.

Dje, Trupi Gjykses shprehu shqetësimin se pothuajse të gjitha dëshmitë deri tani në këtë çështje gjyqësore janë dhënë në seanca private ose të mbyllura, dhe u kujtoi palëve se është në interesin publik që ky proces të zhvillohet, për aq sa është e mundur, në mënyrë publike. Trupi Gjykses udhëzoi palët të mbajnë parasysh parimin e procesit publik dhe lëshoi një urdhër gojor ku kërkoi parashtrime mbi hapat konkretë për të siguruar një shkallë më të lartë publiciteti të procesit gjyqësor.

Pas kësaj, dëshmitari i pestë filloi dje dhënien e dëshminë, një pjesë e së cilës u dha në seancë private dhe një pjesë në seancë publike.

Seancat në DHSK janë publike përveçse kur Trupi Gjykses vendos të mbajë seancë të mbyllur ose të kalojë në seancë private në përputhje me Rregulloren e Procedurës dhe të Provave. Sipas rastit, Trupi Gjykses vendos që pjesë të procesit gjyqësor t'i mbajë në seanca private ose të mbyllura dhe arsyeja kryesore është mbrojtja e sigurisë dhe identitetit të dëshmitarëve dhe viktimave.

Mbrojtja, Prokuroria, ose mbrojtësi i viktimave mund të kërkojnë që e gjithë seanca, ose pjesë të saj, të mbahet në seancë private ose të mbyllur. Vendimi i gjykatësve për miratimin ose jo të kërkesës merret pas shqyrtimit të kujdesshëm, ndër të tjera edhe të rrethanave specifike të dëshmisë ose argumenteve të planifikuara për atë ditë.

Gjykatësit kujdesen që të balancojnë nevojën për të mbrojtur dëshmitarët me të drejtat e të akuzuarve. Pra, edhe kur dëshmia e dëshmitarit nuk është publike, të akuzuarit dhe mbrojtësit e tyre mund të dëgjojnë se çfarë thotë dëshmitari dhe kanë të drejtë ta marrin në pyetje dëshmitarin.

Në Urdhrin mbi Zhvillimin e Gjykimit, Trupi Gjykses në çështjen *Thaçi dhe të tjerët* bëri të qartë se “argumentet ligjore dhe paraqitja e provave nga palët dhe pjesëmarrësit do të bëhet në seanca të mbyllura ose private vetëm kur të jetë absolutisht e domosdoshme...”

Seancat në gjykimin e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit janë planifikuar të vazhdojnë javën e ardhshme, nga e hëna deri të mërkurën.





Në gjykimin e Pjetër Shalës, seancat do të vazhdojnë në javën pas javës së ardhshme. Ato fillojnë të martën, më 30 maj.

Duke mbajtur parasysh natyrën publike të procesit, më 15 maj, Trupi Gjykses në çështjen gjyqësore të Pjetër Shalës urdhëroi palët dhe mbrojtësin e viktimave të bënin rishikimin e transkripteve të seancave gjyqësore nga 1 deri më 3 maj, dhe të bënin parashtrime nëse redaktimet ekzistuese mund të hiqen dhe/ose transkriptet mund të riklasifikohen si publike.

Në përgjithësi, informacioni që është konfidencial në një fazë të procesit, shqyrtohet rregullisht dhe mund të bëhet publik më vonë, në qoftë se kjo mund të bëhet pa rrezikuar dëshmitarët ose pjesëmarrësit e tjerë në proces.

Pyetje nga gazetarët

Një gazetar ngriti një çështje lidhur me transmetimin në internet gjatë seancës së sotme gjyqësore, ku nuk mund të dëgjoheshin sekondat e para të pjesëmarrësve nëse flisnin menjëherë pas pjesëmarrësit paraprak.

Zëdhënësi shpjegoi se, ndonjëherë, nëse një folës fillonte të fliste para se folësi paraprak ta kishte fikur mikrofonin, atëherë fillimi i fjalës së folësit të dytë mund të mos dëgjohej. Ai tha se DHSK-ja i ftonte gazetarët që ta informonin gjykatën kur kishte probleme të tilla dhe se ai do ta informonte personelin përkatës për të parë nëse mund të bëhet ndonjë gjë për ta zgjedhur këtë problem.

